



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 11

Prishtinë, më 29 mars 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Ramadan Gashi, Adem Salihaj, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Kolë Berisha, Selvije Halimi dhe Radmila Vujović.

Munguan: Mufera Şinik në udhëtim zyrtar.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Jetullah Aliu – AKK, Mentor Borovci - AKK, Saranda Stublla – Fol, Petrit Hysaj – OSBE, Sheribane Voca – KDI, Rrezarta Ahmeti – KDI, Lorik Bajrami – Çohu, Blerta Bejtullahu – ICO, Vlora Marmullakaj – EULEX, John Alleglo, USAID, Merita Stublla - Emini – USAID, Lendita Kastrati – EU-AC, David Wocstenholue – EU-AC, Lumnije Murati – ZKRK, Albulena Ademi dhe Dafina Bardhi – praktikante.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Sulltane Gashi dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit i mbledhjes së 22 marsit 2010,
3. Shqyrtimi i Raportit të punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2009,
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për gjykatat,
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 22 marsit 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 22 mars 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2009

Kryetari - Njoftoi se javën e kaluar Komisioni kishte vendosur që ky Raport të shqyrtohej në mbledhjen e sotme, ku do të jenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e Agjencisë. Duke folur për Raportin tha se është i hartuar mirë dhe ka ardhur brenda afatit të paraparë ligjor. Raporti i përfshin njoftimet për të gjitha institucionet dhe procedimet që janë bërë nga kjo agjenci në prokurori për rastet korruptive.

Ky raport ka nevojë për qartësime, por për këtë do të flasim në vazhdim. E ftoi Mentor Borovcin ta marrë fjalën.

Mentor Borovci – AKK - Në fjalën e tij paraqiti sqarime rreth Raportit. I përmendi risitë në fushën e kompletimit të legjislacionit, me të cilin është miratuar strategjia dhe plani i veprimit kundër korrupsionit, si dhe Ligjin e ri kundër korrupsionit, të miratuar, Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit dhe Ligjin për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë. I ceku tri shtyllat të cilat e kanë mbështetur punën e Agjencisë: zbatimi i ligjit, parandalimi i korrupsionit dhe fusha e edukimit. Vuri në pah se gjatë këtij viti kemi rritje të rasteve të raportuara në Agjenci. Paraqiti shifra të rasteve të proceduara në Prokurori, siç janë cekur në raport. E përmendi bashkëpunimin me Prokurorinë e EULEX-it dhe me Policinë e Kosovës. Agjencia në bashkëpunim me prokurorin e shtetit e ka themeluar një “*trup bashkëpunimi*”, në të cilin do të sqarohen problemet dhe çështjet që janë paraqitur në fushën e bashkëpunimit. Në fushën e parandalimit foli për deklarimin e pasurisë, kurse në fushën e edukimit e përmendi vizitën në Republikën e Shqipërisë.

Nga Agjencia Kundër Korrupsionit, në bashkëpunim me UNDP-në, për herë të parë është organizuar konferencë rajonale në fushën kundër korrupsionit.

Ibrahim Makolli - Theksoi se ky më tepër është një raport përshkrues sesa që ofron fakte dhe argumente. I adresoi një varg pyetjesh për përfaqësuesit e Agjencisë: *A ka bashkëpunim me institucionet e tjera? Si është ky bashkëpunim? Cilat institucione nuk bashkëpunojnë? Cilat janë arsyet për mosbashkëpunim, nëse ka të tilla? Cilat janë sfidat? Sa janë zbatuar Strategjia kundër korrupsionit dhe Planin i veprimit dhe sa janë treguar efektive?* Kërkoj sqarime rreth sanksionimit për mosdeklarimin e pasurisë, siç e parasheh ligji. Shtoi se për të pasur suksese në luftën kundër korrupsionit, duhet të ketë bashkëpunim ndërmjet institucioneve, në të gjitha nivelet. Të gjitha këto çështje është dashur të përfshihen në Raport, në mënyrë që Kuvendi të nxjerrë rekomandime ose të kërkojë nga institucionet të ketë bashkëpunim.

Selviqe Halimi - E vlerësoi pozitivisht Raportin, sidomos shkallën e bashkëpunimit me qytetarët. Pyeti: *Pse nuk janë cekur institucionet në raport? A është arsyeja se janë shumë? A ka raste për të*

cilat janë ndërmarrë masa sipas ligjit, që janë propozuar nga Agjencia për ata të cilët nuk iu kanë përmbajtur afatit të deklarimit të pasurisë?

Duke folur për rastet e proceduara në Prokurori, pyeti: *A keni njoftime se deri ku ka arritur procedura për rastet e proceduara nga Agjencia?*

Bajram Kosumi - Theksoi se Raporti në aspektin teknik është i përgatitur mjaft mirë, përfshin fakte më shumë dhe është i elaboruar më mirë.

Edhe pse ka rritje të rasteve të raportuara në Agjenci nga qytetarët, edhe pse ka rritje të rasteve të trajtuara dhe të proceduara në gjykatë, të gjitha këto, edhe pse duken pozitive, përsëri rezultati është i njëjtë, sepse gjykatat nuk i procedojnë më lëndët e proceduara nga Agjencia. E përsëriti qëndrimin se vitin e kaluar e ka shtruar çështjen se Agjencia Kundër Korrupsionit nuk mund t'i argumentojë rastet, të cilat i hetojnë gjykatat ose prokuroritë. Ato nuk duan, nuk munden ose kanë ndonjë arsye tjetër që nuk i procedojnë më rastet. Pyeti: *Cilat janë vështirësitë në të cilat has Agjencia Kundër Korrupsionit gjatë procedurës së mbledhjes së fakteve?*

Adem Salihaj – Tha se ky raport në krahasim me atë të vitit të kaluar është më i avancuar në çështjet formale. Në esencë nuk shoh ndonjë ndryshim në luftimin e korrupsionit, që është rol kryesor. Duke iu referuar shifrave të Raportit për rastet e proceduara, shihet se janë ngritur vetëm pesë aktakuza. Për 62 raste Agjencia nuk ka të dhëna. Në bazë të këtyre me korrupsion prijnë gjykatat, pastaj vijnë ndërmarrjet publike, Qeveria e kështu me radhë. Në vazhdim tha se korrupsionin është mirë ta shqyrtojmë si dukuri shoqërore, ku mund të jetë më i përhapur. Nuk e mohoi mundësinë të këtë më shumë korrupsion në gjykata. Logjikisht Qeveria do të duhej të ishte në vendin e parë, jo vetëm në këtë mandat, por edhe në mandatet e tjera, kur dihet se ajo e menaxhon pjesën më të madhe të buxhetit. Qëllimi është si të luftohet korrupsioni, jo raportimi. Prandaj edhe këtë vit nuk ka ndonjë përparim të dukshëm, pa marrë parasysh lëvizjen pozitive të raportimit të rasteve nga qytetarët në Agjenci.

Adem Hajdaraj - Kërkoj sqarim për çështjen e deklarimit të pasurisë, siç parashihet në tabelën 14 të Raportit, në të cilën i keni paraqitur disa emra. *A i është zbritur ndokujt paga, sepse këtu shihet një përqindje mjaft e lartë e deklarimit të pasurisë? Sa është reale kjo, po të merren parasysh vonesat në këtë aspekt?*

Armend Zemaj - Tha se kemi kontribuar në pakon legjislative gjatë këtij viti. Sigurisht si agjenci e re përballat edhe me vështirësi për kompletim me staf. Pika e parë, të cilën e vlerësoi, është sensibilizimi i opinionit në paraqitjen e rasteve e korrupsionit. Nuk dua ta shoh Agjencinë vetëm si preventivë, kur dihet se është edhe Departamenti i Hetimeve, në mënyrë që lëndët, të cilat dërgohen në gjykatë, të mbështeten me fakte. Theksoi se rastet e përmendura të mos jenë të përgjithësuara, por të specifikuara, aty ku është bërë hetimi dhe të shihet rezultati konkret. Shtoi se duhet të krijohet një linjë bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të pavarura.

Radmila Vujović – I përshëndeti të pranishmit dhe përfaqësuesit e Agjencisë. U interesua se cili është bashkëpunimi me Policinë dhe me gjykatën për rastet e proceduara nga Agjencia.

Ibrahim Makolli – Sërish iu referua faqes 13 të Raportit. Tha se duhet të dihen saktë institucioni dhe adresa, sepse nuk ka çka të fshihet. Nuk duhet të thuhet “*institucionet e tjera*”, sepse institucionet kanë adresë dhe dihet cilat janë. Ishte i mendimit që raporti të plotësohet me emërtime të institucioneve.

Ramadan Gashi - Kërkoj sqarim rreth buxhetit vjetor ku bëhet fjalë për kategoritë ekonomike, për mallra dhe shërbime, që janë kategori që më së shumti shpenzojnë pa specifikime, kur dihet se ky institucion nuk është i sapothemeluar që ta ketë 40% të buxhetit për mallra dhe shërbime.

Në pyetjet e shtruara u përgjigjën Mentor Borovci dhe Jetullah Aliu.

Kryetari - Kërkoj sqarim rreth njoftimeve anonime. *Si mund të ngritin gjykata dhe prokurorët aktakuza me njoftime anonime?*

Adem Salihaj - Propozoi që Komisioni në një mbledhje të radhës t'i nxjerrë rekomandimet dhe vërejtjet e kësaj mbledhjeje. Pas diskutimeve në Komision të miratohen dhe Raporti të dërgohet në Kuvend.

Ibrahim Makolli - Propozoi të formohet një grup për t'i nxjerrë disa rekomandime, që t'i miratojmë në mbledhjen e radhës. Raportin do ta dërgojmë për shqyrtim të mëtejshëm.

Lidhur me këtë Komisioni e nxori këtë

P e r f u n d i m

- I. Formohet grupi i punës për nxjerrjen e rekomandimeve lidhur me Raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit me këtë përbërje: Bahri Hyseni, Bajram Kosumi, Armend Zemaj dhe Radmilla Vujović.
- II. Grupi i punës e ka për detyrë ta shqyrtojë Raportin dhe Komisionit t'ia paraqesë rekomandimet.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për gjykatat

Komisioni e shqyrtoi në parim Projektligjin për gjykatat, që procedohet për shqyrtim të mëtejshëm.

4. Të ndryshme

a. Njoftim rreth vonesës së raporteve

Kryetari - I njoftoi anëtarët se ka vonesa të tepruara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, nga Komisioni për të Drejtat e Komuniteteve dhe Kthim dhe nga Komisioni për Integritet Evropian. Theksoi se këtë çështje do ta hapim në Kuvend, sepse Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi po arrin me kohë t'i shqyrtojë projektligjet, kurse për çështje krejt formale ato vonohen në komisione të tjera.

b. Njoftim rreth mbajtjes së dëgjimit publik

Bajram Kosumi - I njoftoi anëtarët se Nënkomisioni për shqyrtimin e Projektligjit për Avokatin e Popullit ka mbajtur takim, në të cilin janë caktuar dy grupe të ekspertëve, ndërsa administrata është ngarkuar t'i ftojë ekspertët. Kërkoj të caktohet data e dëgjimit publik.

Komisioni u njoftua nga përfaqësuesi i OSBE-së se e ka mbështetjen për organizimin e dëgjimit publik dhe u vendos të mbahet më 16 prill 2010.

c. Shqyrtimi i bazës juridike të projektligjeve

Komisioni e shqyrtoi bazën juridike të projektligjeve:

1. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për tatimin në vlerën e shtuar.
2. Projektligji për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe për financimin e terrorizmit.
3. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për procedurën administrative.

Komisioni vlerësoi se projektligjet kanë bazë juridike në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni